

“MASTER AL” SHPK –STATUTI

KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Ne Tirane me date 12 Janar 2021 (dymije e njezete e nje)

NENI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1** Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “MASTER AL” SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2** Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.3** Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

NENI 2 SELIA

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Koder Vore, zona kadastrale 2183, numer pasurie 102/12 Tirane, Shqipëri.
- Ortaket e Shoqërisë mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1** Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:
Ne fushën e tregtisë: Import eksport me shumice e pakice, tregtim të mallrave industriale, ushqimore, blektorale e bujqesore, veshmbathje, automjete, makinerive, paisjeve hidrosanitare, veshje, mobiljeve, artikujve

kozmetike, konfeksioneve, kancelari.Tregti me pakice te vajrave lubrifikante e karburanteve. Ne fushen e ndertimit .Per zbatim e projektim e ndertime civile, ekonomike, punime dheu, sistemimin, taracime, prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni e beton arme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Ndertim rruge te kategorive te ndryshme, veshje me asfalto beton te rrugeve/ndertimmbishtrese/ sistemim e asfaltim sheshi.Hapje komplekse sportive, hapje bar bufe,restaurante, te hoteleve, pika servisi, lavazhe, fshatrave turistike, moteleve, si dhe anXHensi per shit-blerje e dhenia me qira te pasurive te tundshme e te patundshme, anXHensi komisionere, transport te udhetareve e mallrave si brenda dhe jashte vendit. Shërbime Marketing.

- 4.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve.
- 4.3 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 10 000 (dhjete mije) Lekë, i përbërë nga 1 (nje) kuote me vlerën 10 000 (dhjetemije) Lekë, që përfaqësojnë 100% të kapitalit, i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku i vetem **Z. Skifter Tagani**, lindur ne Tirane, me 22 Shkurt 1969, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. G90222130U, banues ne Rruga “Maliq Muco ” Njesia Nr.9 ,apartamenti nr 19 kati 5, Tirane, Shqipëri, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

NENI 6

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET

- 6.1 Kuotat e shoqërisë mund t’u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Ortaket e Shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë sigurorese apo të drejta të tjera reale.

KREU III NDRYSHIMI I KAPITALIT

NENI 8

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Ortakeve të Shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Ortakeve apo Administratoreve të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 9 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1** Ortaket e Shoqërisë, mund të vendosin që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortaket e Shoqërisë, me vendim të kene miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortaket e Shoqërisë caktojnë një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit

themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.

- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, ortakët e shoqërisë, me një vendim tjetër, përcaktojnë mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortaket e shoqërisë, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

KREU IV ORGANIZIMI I SHOQËRISË NENI 10 STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1** Shoqëria tregtare “MASTER AL” SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Ortaket e shoqërisë si organi vendimmarrës për shoqërinë;
 - Administratoret

NENI 11 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 11.1** Ortaket e shoqërisë, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.2** Ortaket e shoqërisë marrin vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës “1” të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqërisë do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të ortakeve të shoqërisë. Ortaket e shoqërisë, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.
- 11.4** Nga ana e Ortakeve të shoqërisë merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statuti.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti

ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMARRËS

- 12.1** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”., nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakeve thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nga kryesisht nga ortaket e shoqerise, administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Ortakeve te shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Ortakeve. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

KREU V

ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET

NENI 13

ORTAKET E SHOQERISE

- 13.1** Ortaku i vetem i Shoqërisë .:
- **Z. Skifter Tagani**, lindur ne Tirane, me 22 Shkurt 1969, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. G90222130U, banues ne Rruga “Maliq Muco ” Njesia Nr.9 ,apartamenti nr 19 kati 5, Tirane.

NENI 14

VENDIMET E ORTAKEVE E SHOQERISE

- 14.1** Ortaket e shoqerise, në përputhje me legjislacionin shqiptar marrin vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakeve te shoqerise.
- 14.2** Vendimet e Ortakeve te shoqerise duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 15

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE TE SHOQERISE

- 15.1** Të drejtat dhe detyrat e ortakeve te shoqerise janë:
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakeve;
 - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
 - Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
 - Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
 - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

NENI 16

FINANCIMI I SHOQËRISË

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejte të kërkojë nga ortaket e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

KREU VI ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (nje) Administratore te cili emërohen nga ortaket e shoqerise për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratore te shoqerise emërohen:
- **Z. Skifter Tagani**, lindur ne Tirane, me 22 Shkurt 1969, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. G90222130U, banues ne Rruga “Maliq Muco ” Njesia Nr.9 ,apartamenti nr 19 kati 5, Tirane, Shqipëri.
- 17.2** Në zbatim të këtij neni, administratoret e shoqerise përfaqësojne Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve te shoqerise apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- 18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për

- shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakeve të shoqërisë për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - e) raportoje përpara Ortakeve të shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 - f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 19 PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT

- 19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 20 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

- 20.1** Ortaket e shoqërisë përcaktojnë shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 21 KONTROLLI KONTABËL

- 21.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaket e shoqërisë do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

- 21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22

VITI FINANCIAR

- 22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 23

BILANCI DHE REZERVAT

- 23.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaket e shoqërisë të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2** Ortaket e shoqërisë vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 23.3** Ortaket e shoqërisë në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

NENI 24

PUNËSIMI NË SHOQËRI

- 24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

KREU VIII

PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 25 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 25.1** Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaket e shoqërise.
- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaket e shoqërise emërojnë një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria priset në këto raste:
- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
 - Me vullnetin e ortakëve;
 - Me vendim të Gjykatës
 - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

NENI 26 PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare “MASTER AL ” SHPK vendoset nga Ortaket e shoqërise kur priset shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 26.3** Në qoftë se Ortaket e shoqërise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrin vendim ose nuk pranojnë të miratojnë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.

- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakeve të shoqërisë zbaton dispozitat ligjore dhe nëse miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirren Ortaket e shoqërisë për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

NENI 27
NJOFTIMET

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do të drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU IX
BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË

NENI 28

- 28.1** Shoqëria “MASTER AL ” SHPK me anë të bashkimit mund të kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron të njëjtin aktivitet.

"MASTER AL" SHPK -STATUTI

- 28.2** Gjithashtu shoqëria "MASTER AL" SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4** Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Ortaket e shoqërisë.

KREU X DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 29 LIGJI I ZBATUESHËM

- 29.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 30

- 30.1** Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

" MASTER AL " SHPK

Z, Skifter TAGANI

SKIFTER TAGANI

